

Format e Ndhmës Juridike:

a) Ndhma Juridike Parësore që do të ofrohet nga:

- Punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme;
- Organizatat jofitimprurëse të autorizuara që japin shërbime të ndihmës juridike parësore të miratuara nga Ministria e Drejtësisë pasi kanë përmbushur kriteret ligjore të mirëpërcaktuara në aktin nën ligjor përkatës;
- Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë;

b) Ndhma Juridike Dytësore që do të ofrohet përmes:

- Avokatëve që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve dhe në bazë të kërkesës që paraqitet para gjykatës kompetente;
- Përrashtimit nga pagesa të tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet dhe ajo e udhërit të ekzekutimit;

Institucionet e zbatimit të Ligjit të Ndhmës Juridike të Garantuar nga Shteti:

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është mekanizmi në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që ka për detyrë të sigurojë bazën institucionale dhe financiare të ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.
- Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore. Ato do të vendosen ose në Gjykata ose në ambientet e pushtetit vendor. Dihet që në njërin apo tjetrin institucion qytetarët paraqesin kërkesat e tyre ligjore për aksesin në shërbimet që duhet të sigurojnë ato.
- Drejtoria e Ndhmës juridike ka detyrimin të bëjë thirrjen për OJF-të që duhet të autorizohen duke kryer procedurën e verifikimit të dokumentacionit dhe kriteret ligjore të përcaktuara në VKM nr.55 datë 6.2.2019
- Ministri i Drejtësisë miraton autorizimin për OJF-të që plotësojnë kriteret për t'u financuar nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore.

Struktura e Drejtorisë së Ndhmës Juridike:



Ndhma Juridike është instrumenti më efikas për t'i garantuar individit aksesin në drejtësi. Përmes Ndhmës Juridike çdo individ në pamundësi financiare mund të marrë mbështetjen e nevojshme për realizimin e të drejtave të tij.

Aksesi në drejtësi është i lidhur ngushtë me ofrimin Ndhmës Juridike Falas. Koncepti i Ndhmës Juridike përfshin tërësi shërbimesh ligjore që i ofrohen individëve në nevojë. Aksesi në drejtësi ndër të tjera është akses në shërbime ligjore që përfshijnë informacion, këshillim, përgatitje dokumentesh dhe përfaqësim.

SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE

04 2258442 - 0692093731
www.flas.org.al - flas@flas.org.al
www.portal.flas.org.al

ADRESA:
Pallatet Agimi, Shkalla 18 /322
P.O BOX 69, Tiranë, Shqipëri

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



**NDIHMA JURIDIKE
E GARANTUAR NGA SHTETI**